



Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë,06.07.2021

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 05.07.2021 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "RISAMONT SHPK", për aktivitetin: "Ndërtimi i trafos elektrike për ndërtesën e Sindrom Down dhe Autizem Nr. të Prok: 616 21 057 521 nxjerr:

V E N D I M

1. Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik "RISAMONT SHPK", për aktivitetin: "Ndërtimi i trafos elektrike për ndërtesën e Sindrom Down dhe Autizem Nr. të Prok: 616 21 057 521", kundër Vendimit Të AK-së, të datës 29.06.2021 të publikuara në web-faqe të KRPP-së.

2. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdojë aktivitetin sipas publikimit të Vendimit të AK-së të datës 29.06.2021.

3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Arsyetim

Operatori Ekonomik " RISAMONT SHPK " me datë 05.07.2021 ka parashtruar kërkesën për rishqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Ndërtimi i trafos elektrike për ndërtesën e Sindrom Down dhe Autizem Nr. të Prok: 616 21 057 521**

Autoriteti Kontraktues, me datë 06.07.2021, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon:

Vleresimi i tenderit është bërë nga një ekip profesional, i cili ka analizuar të gjitha dokumentacionet e dorëzuara si dhe çmimet e dhëna nga tenderuesit dhe i njëjti ka konstatuar se tenderuesi me çmimin më të ulët që është rekomanduar për dhenje të kontratës ka dhënë çmime reale.


Prandaj pretendimet tuaja refuzohen si të pa bazuara dhe të pa argumentuara, pasi që ju nuk keni dhënë asnjë dëshmi lidhur me pretendimet tuaja.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Vendimi i dërgohet parashtruesit të kërkesës , departamentit të prokurimit dhe njësis së kërkesës.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) diteve pas pranimi të këtij vendimi.


Zyrtari përgjegjës i Prokurimit